



Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa për Legalizim të gjendjes ekzistuese dhe Vazhdimin e Punimeve me numër të kërkesës **05 Nr.351/01-162302/21 dt.10.08.2021**, e aplikuesit Valon Kastrati, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara të ndryshimit të destinimit si dhe vazhdimin e punimeve të ndërtesës me etazhitet B+P+2 në bazë të kriterëve të PZHU-së në Prishtinë, në parcelën kadastrale, nr.10155-0 ZK Prishtinë. Kërkesa përcakton kriteret për vazhdimin e ndërtimit dhe ndryshimin e destinimit, trajtohen sipas Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e ndërtimeve pa leje, kurse vazhdimi i punimeve sipas kriterëve të Planit Zhvillimor Urban.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data

13.03.2026 deri më 28.03.2026, në E-mail adresën: urbanizmi@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Pike e shitjes së naftës dhe afariste / Propozimi Sipas projektit konceptual-Ndërtes administrate / afarizem
b. Vija rregulluese	Sipas PZHU-së
c. Vija ndërtimore	E propozuar 7.5m', Rruge Private
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	Sipas PZHU-së 20 m' / e propozuar 44 m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasëm të parcelës kadastrale.	Anët - Djathtas 7.5 m' Anët – Majtas 7.0 m' dhe 15.04 m' Pasëm 1.6 m' me pëlqim
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	40% e lejuar ~ 38.5 % e propozuar
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	Nuk ka koficent të përcaktuar Sipas PZHU-së me rrethinë 50 m'
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	1680 m2
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	ISHN=60% , propozuar 56.70m ²
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	275 VP, të brendshme & të jashtme
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Po
1. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimin për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafi 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Nënshkrimi i Zyrtares: